



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.383/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Skender Çoçaj kryesues, Kymete Kicaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.02.2025, merr këtë:

### **V E N D I M**

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.383/2025 e datës 05.02.2025, e parashtruar nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

### **A r s y e t i m**

Me datë 05.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë me të cilën pretendon me date 04.02.2025, kanë vërejtur se në rrugët/hapsirat publike, në Sheshin "Nëna Terezë" në Prishtinë, është vendosur baneri/posteri i kandidatit për deputet Albin Kurti nga radhët e subjektit politik LVV, pa lejen dhe pëlqimin e Drejtorisë për Shërbime në Komunën e Prishtinës, i cili veprim është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës- LZP. Andaj, duke u bazuar në gjithë këto kërkojnë nga PZAP-i, si organ kompetent dhe i autorizuar që të shqiptoj masë sanksionuese ndaj subjektit politik LVV dhe kandidatit në fjalë.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit të kandidatit për deputet Albin Kurti pa lejen e pronarit shfrytëzuesit të kësaj hapësire.

Më datë 06.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 06.02.2025 në ora 19:00.

Në përgjigje në ankesë Subjekti Politik LVV thekson se i kundërshtojnë pretendimet në ankesë në tërësi, sepse e njëjta nuk përmban ndonjë fakt dhe provë e cila bie ndesh me nenin 34 të LZP-së, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2. Më tutje në përgjigje në ankesë theksojnë se për shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin “Nëna Terezë” para Ministrisë së Kulturës, ku është vendosur baneri/ posteri në fjalë, LVV deklaroi se posedojnë leje/ pëlqim i cili është lëshuar me 31 Dhjetor 2024 nga Drejtoria Komunale për Shërbime, të cilëve u është dhënë pëlqimi për shfrytëzim të hapësirës publike në fjalë, deri më datë 10 Shkurt 2025.

Më tej në përgjigje thuhet se vendosja e posterve/ banerve në shtand ose murin e shtandit, është në përputhje me nenin 44 dhe 34 të LZP-së si dhe me nenin 5, të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimin financiar për faktin se marrja në shfrytëzim të shtandit përmes pëlqimit të Komunës, nënkupton të drejtën e shfrytëzimit të atij shtandi me hapësirën përkatëse nga LVV dhe njëkohësisht ai shtand është hapësirë e lejuar për shfrytëzimin dhe publikimin e materialeve zgjedhore. Andaj kjo është arsyeja për vendosjen e shtandit dhe marrjes së lejes. Me qëllim të publikimit dhe shpërndarjes së materialeve zgjedhore. Edhe pse një gjë të tillë e arsyeton edhe Rregullorja Zgjedhore nr. 07/2024 Fushata e Zgjedhjeve, monitorimi i fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimi financiar, Konkretisht neni 5 par 1, nenpar1.2 i rregullores Zgjedhore nr. 07/2024 Fushata e Zgjedhjeve ,monitorimi i fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimi financiar i cili thotë se:

5.1 Gjate periudhës së fushatës zgjedhore, siç përcaktohet në nenin 44 të LZP, subjektet politike të certifikuar kanë të drejtë:

5.1.2 të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandëve apo në hapësira publik, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore:

Për më tepër, një veprim të tillë i cili ka leje/ pëlqim, nga organi përkatës, nuk përbën shkelje të nenit 34, të LZP-së paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, si dhe nuk përbën shkelje të Rregullores Zgjedhore, nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, monitorimin e fushatës së zgjedhjeve dhe deklarimit financiar.

Si provë në përgjigje kanë bashkangjitur Leje - Pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Shërbime e Komunës së Prishtinës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se :

- Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik LVV, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik PDK, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat*

*ndërkombëtare ose brenda ose ne hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitës ligjore të lartcekur, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura në përgjigje në ankesë në këtë rast, Pëlqimin e leshur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike të Komunës së Prishtinës, mbi shfrytëzimin e përkohshëm të hapësirës publike në sheshin “Nëna Terezë”, për vendosjen e shtëpizës për shpalosjen e programit, vërtetoi se shtëpiza e vendosur nga Subjekti Politik LVV, është në pajtim me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, neni 5. Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve publike konkretisht nën paragrafi 1.2 *“të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandeve apo ne hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”*.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkuara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.383/2025 datë 07.02.2025

**Kryesues i Panelit**  
**Skender Çoçaj**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.